



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

CA.nr. 2086/2018

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gani Avdiu Kryesues, Hunaida Pasuli e Faton Ademi, - anëtarë, (më tej kolegji) në kontestin e paditësit B.G., nga Fushë Kosova, i përfaqësuar nga F.M. av. në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “C...” me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga V.R., për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2559/11 të datës 11.12.2017, në seancën e kolegjit, të mbajtur me dt. 17.06.2021, jep:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa themeltë ankesa të paditurës K.S. “C...”, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2559/11 i datës 11.12.2017, **Vëretohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin C.nr.2559/11 i datës 11.12.2017, ka vendosur si vijon:

“Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit B.G. nga Fushë Kosova, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “C...” në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, të pësuar si pasojë e aksidentit të trafikut, i cili ka ndodh me datë 31.10.2010, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 7,600.00, me kamatë prej 12% si dhe shpenzimet e procedurës.

Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale”.

Kundër këtij aktgjykimi, përfaqësuesi i paditësit av. F.M. me datë 30.03.2018, ka paraqitur një ankesë me të cilën ka kërkuar që aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja të

kthehet në rigjykim, duke parashtruar këto shkaqe: *Shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.*

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Kompetenca: Kolegji, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, e në bazë të shkresave në dosje përfshirë edhe ankesat, vlerësoi se ka juridiksion për procedim dhe vendimmarrje në këtë çështje juridike, duke u bazuar në nenet: 22 e 23 të Ligjit për gjykatat, (“Gazeta Zyrtare” e Republikës së Kosovës” nr. 22/2018), si dhe neneve 190 e 194 të LPK.

Shqyrtimi i ankesës: Gjykata e shkallës së dytë duhet të shqyrtoj pranueshmërinë e ankesave, në raport me kërkesat ligjore të specifikuara me nenet 176, 178 e 186 të LPK, para se të vendosë për themelësinë e tyre.

Me vështrim në shkresat e lëndës (Fletë kthesat për dorëzimin e aktgjykimit të shkallës së parë si dhe zarfi për dorëzimin e ankesës në postë) rezulton se ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor, është e lejueshme sepse është paraqitur nga personi që ka interes juridik, ndërsa paraprakisht nuk është hequr dorë nga e drejta në ankim, kurse ankesa e paraqitur nuk është tërhequr deri në ditën e vendim marrjes.

Ankesa e paraqitur përmban elementet e përcaktuara me ligj, pra ajo është e plotë.

Kolegji, vlerëson se ankesa i përmbush kërkesat ligjore nga nenet 176,178 lidhur me nenin 186 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 38/08), i datës 20 shtator 2008, i cili ka hyrë në fuqi me 6 tetor 2008 (më tej LPK).

Kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë: Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në bazë të nenit 194, të LPK e ekzaminoj aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore, dhe gjeti se:

Ankesa është e pa themeltë.

Kolegji, konstaton se gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës kontestimore nuk ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 b) g) j) k) dhe m) të LPK, për të cilat gjykata e shkallës së dytë në procedurë sipas ankesës, e në bazë të nenit 194 të LPK, kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as shkeljet tjera të cekura në ankesë të cilat do të ishin me ndikim në vendimmarrje të ligjshme e të drejtë në zgjidhjen e këtij kontesti.

Nga shkresat në lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë, me dt. 11.12. 2017, kishte bërë shqyrtimin kryesor të çështjes, kishte marrë provat e përshkruara në procesverbalin e seancës përkatëse dhe kishte konstatuar gjendjen faktike të përmbajtur në arsyetimin e aktgjykimit ankimor si vijon: në mes të ndërgjyqësve nuk ishte kontestues fakti se me datën 31.10.2010, kishte ndodhur një aksident komunikacioni në të cilin ishin përfshirë veturat, të cilën e drejtonte paditësi B.G. si dhe vetura të cilën e drejtonte A.A., e cila në momentin e shkaktimit të aksidentit ishte siguruar të e paditura, mirëpo fakt kontestues ishte se paditësi si pasojë e këtij aksidenti a ka pësuar apo jo lëndime trupore.

Nga raporti policor i datës 31.10.2010 rezulton se si pasojë e aksidentit janë shkaktuar dëme materiale. Nga aktvendimi i gjykatës komunale për kundërvajtje në Prishtinë nr. regj. 34966/10 i datës 25.05.2011, rezulton se e siguruar e të paditurës, është shpallur përgjegjës për aksidentin e datës 31.10.2010, në aksident është shkaktuar vetëm dëm material në të dy veturat.

Nga dokumentacioni mjekësor i QMF në Prishtinë rezulton se paditësi i është nënshtruar kontrollit mjekësor me datën 08.11.2010 dhe 10.11.2010. Ekspertët mjekësor Dr. XH.S.- Ortoped/Traumatolog, dhe Dr. N.M.- Psikiatër, kanë konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore, ndrydhje të qafës si dhe frikë primare dhe sekondare.

Në bazë të kësaj gjendje të çështjes gjykata e shkallës së parë kishte vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa themeltë sepse nga provat e administruara, raporti i aksidentit i datës 31.10.2010 dhe aktvendimi i gjykatës komunale për kundërvajtje në Prishtinë,

u konstatua, në aksidentin e datës 31.10.2010, është shkaktuar vetëm dëm material në dy veturat e aksidentuara, pra nuk ka pasë persona të lënduar.

Nga dokumentacioni mjekësor rezulton se paditësi është lajmëruar në QMF Prishtinë me datën 08.11.2010, pra 8 ditë pas aksidentit, pra nuk u provua fakti se dëmi material dhe jo material, për lëndime trupore të cilat paditësi pretendon se janë pasojë e aksidentit të datës 31.10.2010.

Gjykata e shkallës së parë, raportin mjekësor të Qendrës Kryesore të Mjekësë Familjare në Fushë Kosovë, si dhe mendimin e ekspertëve Dr. XH.S. dhe Dr. N.M., nuk i ka konsideruar prova të besueshme dhe relevante për të provuar faktin vendimtar se pala paditëse ka pësuar lëndime trupore në ngjarjen aksidentale të datës 31.10.2010.

Pretendimet ankimore: Përfaqësuesi i paditësit av. F.M., në ankesë ka pohuar se aktgjykimi ankimor është i paqartë, kontradiktor me arsyetimin e tij.

Gjykata e shkallës së parë gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë ka konstatuar gjendjen faktike në dëm të paditësit sepse nga provat e administruara është vërtetuar se paditësi me dt. 31.10.2010, ka pësuar lëndime trupore, fakt që vërtetohet nga raporti i QKMF-së në Fushë Kosovë, i dt. 01.11.2010, raportet tjera mjekësore nr.599 të dt.13.09.2017, si dhe me deklarimin e mjekëve ekspertë.

Pra aktgjykimi nuk është i bazuar në këto prova, por vetëm në raportin e aksidentit dhe aktgjykimin e Gjykatës për Kundërvajtje të cilat nuk kanë fuqi provuese për lëndime trupore.

Kjo bazohet në faktin se policia mundë të del në vendin e ngjarjes dhe lëndimet e lehta trupore nuk mundë ti konstatojnë dhe nuk janë të thirrur për konstatimin e lëndimeve të lehta trupore.

Po ashtu as me aktvendimi e Gjykatës për Kundërvajtje, nuk mundë të konstatohen lëndimet trupore sepse paditësi nuk është thirr në seancë sepse nuk ka qenë palë në këtë procedurë.

Andaj në bazë të kësaj gjendje të çështjes, kontrollimit mjekësor të paditësit brenda 24 orëve pas aksidentit, si dhe konstatimi dhe mendimi i ekspertëve mjekësor të cilët kanë dhënë sqarime të mjaftueshme vërtetohet se paditësi në ngjarjen aksidentale të dt. 31.10.2010, ka qenë pjesëmarrës dhe ka pësuar lëndime trupore.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë të shprehur në aktgjykimin ankimor, kolegji e vlerëson të bazuar në ligj e të drejtë, kurse pretendimet ankimore të paditësit ishin të pa themelta.

Gjykata e shkallës së parë në këtë rast drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike sepse nga provat shkresore: Raporti i aksidentit Nr. 2010-3653 i datës 31.10.2010 i Policisë së Kosovës, rezulton se në ngjarjen aksidentale të datës 31.10.2010 në Rr. “Eqrem Çabej” në Prishtinë ishin shkaktuar vetëm dëme materiale.

Me aktvendimin e Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë Nr. regj. 34966/10 të dt. 20.05.2011, i plotfuqishëm nga data 03.06.2011 ishte konstatuar se në ngjarjen aksidentale të dt. 31.10.2010, ishin ndeshur veturat: e tipit “Mercedes” me targa të cilin ditën kritike e drejtonte A.R.A., dhe vetura e tipit “Audi” me targa të regjistrimit të cilën ditën kritike e drejtonte tani paditësi B.G., si pasojë e kësaj ngjarje aksidentale ishte shkaktuar *“vetëm dëm material në të dy veturat”*.

Kolegji, vlerëson se provat shkresore si: Raporti policor Nr. 2010-3653 i datës 31.10.2010 dhe aktvendimi i Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë Nr. regj. 34066 i datës 20.05.2011, i formës së prerë, janë dokumente publike sepse janë lëshuar nga organet shtetërore brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në kuptim të nenit 329 të LPK, provojnë saktësinë e asaj që konfirmohet në këto dokumente.

Andaj, është i drejtë konkluzioni i gjykatës së shkallës së parë se ditën kritike si pasojë e ngjarjes aksidentale të ngjarjes aksidentale të datës 31.10.2010, ishin shkaktuar vetëm dëme materiale në vetura.

Kolegji, vlerëson se pretendimi ankimor i përfaqësuesit të paditësit, se paditësi ditën kritike ka pësuar lëndime trupore si pasojë e ngjarjes aksidentale të datës 31.10.2010 dhe se ky

fakt është konfirmuar mbi bazën e asaj se paditësi brenda 24 orëve pas aksidentit ka kërkuar ndihmë mjekësore në QKMF në Fushë Kosovë, është i pathemeltë.

Në shkresat e lëndës nuk ka raport mjekësor, të Institucionit kompetent shëndetësorë, por ekziston një “Dëftesë për bashkë pagesë” e datës 01.11.2010, në të cilën nuk është shënuar viti i lindjes së personit (tani paditësit), emri dhe mbiemri i personit është i pa lexueshëm, numri i dëftesës nuk ekziston, *është i mbuluar me ngjyrë të zezë*, nuk ka numër protokollit, pra të dhënat e kësaj dëftese, nuk dëshmojnë se tani paditësi me datën 01.11.2010 ka kërkuar ndihmë mjekësore, në QKMF në Fushë Kosovë.

Dëftesa përkatëse, nuk përmban të dhëna të plota dhe të qarta, se paditësi në Institucionin Shëndetësorë kompetent me datën 01.11.2010, ka kërkuar ndihmë mjekësore për shkak të ngjarjes aksidentale të datës 31.10.2010.

Kolegji, konstaton se Raporti mjekësor i datës 13.09.2017 i lëshuar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale QKMF “Dr. Fatmir Krasniqi” në Fushë Kosovë, me nr. 4961, është i fotokopjuar, në të nuk ka konfirmim se paditësi me datën 01.11.2010, ka kërkuar ndihmë mjekësore për shkak të ngjarjes aksidentale të datës 31.10.2010, por vetëm ekziston konstatimi se: “Raporti lëshohet me kërkesë të pacientit si dëshmi për gjendjen e tij shëndetësore me datën 01.11.2010.”

Raporti, nuk ka të dhëna të protokolluara zyrtare, së tani paditësi, sipas evidencës zyrtare të datës 01.11.2010, kishte kërkuar ndihmë mjekësore si pasojë e ngjarjes aksidentale të datës 31.10.2010 dhe se atij i ishte caktuar diagnozë dhe terapi mjekësore.

Andaj, kolegji vlerëson se paditësi në këtë rast edhe përkundër faktit se e ka barrën e provës nuk dëshmoj me prova bindëse se si pasojë e ngjarjes aksidentale të datës 31.10.2010 ka pësuar lëndime trupore, si fakt vendimtar për të vlerësuar themelësinë e kërkesëpadinë e tij kundër të paditurës.

Më sa u tha më lartë, kolegji vlerëson se janë krijuar kushtet ligjore nga neni 200 i LPK, për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË

CA. nr.2086/2018dt. 17.06.2021.

Kryesuesi i Kolegjit – gjyqtari

Gani Avdiu